

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ZAIM GROUP”**

Sot më datë 08.03.2024, në cilësinë e ortakut themelues,

Unë i nënshkruari Z. Blerim Dragjoshi, lindur me 19/06/1985, me banim në Tiranë, me nr. personal identifikimi I50619097P, shtetas shqiptare dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, dhe me vullnetin tim të lirë vendosa:

Themelimin e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kuifuar “**ZAIM GROUP**” Sh.p.k, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligjin Nr.9901, date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, nënshkruar nëpërmjet këtij akti si vijon:

**NENI 1
EMËRTIMI DHE FORMA**

Emërtimi i shoqërisë është “**ZAIM GROUP**” Sh.p.k, më poshtë e quajtur "Shoqëria".

Shoqëria është person juridik me përgjegjësi të kufizuar dhe vepron sipas legjislacionit Shqiptar. Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara në ligj, si dhe është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

**NENI 2
SELIA E SHOQËRISË**

Selia kryesore e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga “Adem Jashari”, Nd.17, H.1, Kamëz, Tiranë. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësimi, të krijoj filiale, si brenda dhe jashtë vendit Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Ortakut të shoqërisë.

**NENI 3
KOHËZGJATJA**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**NENI 4
OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

Shoqëria “**ZAIM GROUP**” Sh.p.k, do të ketë si objekt të ushtrimit të veprimtarisë si vijon:

- Import-eksport, tregtim, shit-blerje, dhënen me qira të automjeteve dhe mjetet motorrike (autovetura, furgona, kamionë, motoçikleta, mjete të rënda, etj), të reja dhe të



përdorura, automjeteve jashtëpërdorimit apo pjeseve të këmbimit, si dhe kryerjen e çdo aktiviteti tjeter që lidhet me automjetet.

- Aktivitet ndërmjetësimi në çdo fushë, konsulencë dhe shërbime ligjore, ekonomike, financiare, të teknologjisë dhe informacioni, shit-blerje dhe dhënie me qira të pasurive të luajtshme dhe të paluajteshme me pagesë dhe/ose me kontratë.
- Aktivitet dhe shërbime në fushën e turizmit, hotelerisë, bar-restoranteve, etj. Organizim dhe shërbim të aktiviteteve dhe paketave turistike, bileta avioni, trageti, autobusi dhe/apo të mjeteve të ndryshme të organizimit e formave të udhëtimeve turistike. Transport kombëtar dhe ndërkontinentar për vete, për të tretë, me qira dhe taksi.
- Veprimitari të Agentit të sigurimeve, shërbimeve të pagesave elektronike ose jo, të transferimit të parave në emër dhe për llogari të të tretëve, këmbimit valutor, Shërbime në faqe internet (website services), marketing dhe shitje online, etj.
- Projektim, instalim, operim dhe mirëmbajtje e sistemeve dhe rrjeteve të komunikimit, pajisjeve dhe softwareve në fushën e TIK, tregimin e të gjitha artikujve me përbajtje elektronike, si kompjutera, printerë, pajisje, skanera, data storage, POS, bateri, sisteme sigurie, etj).
- Tregimin i mallrave/artikujve të ndryshëm me shumicë dhe pakicë, tregimin e materialeve industriale, të ndërtimit, elektoshtëpiake, hidrosanitare, elektrike, hidraulike, elektronike, kancelarike dhe didaktike, etj.
- Shërbime higjieno-sanitare të ambienteve të brendshme dhe të jashtme dhe shërbime të paketës DDD (Dizinfektim, Dizinsektim, Deratizim) si dhe tregim i materialeve të pastrimit.
- Kryerjen e veprimtarisë në fushën e ndërtimit, rikonstruksione, projekte, kolaudime, mirëmbajtje apo restaurime, me fonde private apo publike të objekteve të ndryshme sociale kulturore, industriale, turistike, bujqësore, impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit.
- Shoqëria do të krye të gjitha aktivitetet e mësipërme, si edhe cdo aktivitet tjeter tregtar që nuk është i ndaluar nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

NENI 5 **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar i nënshkruar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj shoqërie, në vlerë monetare 100.000 (njëqindmijë) lekë. Kapitali ndahet në 1 (një) kuotë, e cila zotërohet nga ortakët si më poshtë:



1. **Blerim Dragjoshi**, në cilësinë e ortakut themelues zotëron 100% të vlerës së kapitalit themeltar, e barabartë me 1 kuotë me vlerë 100.000 lekë.

Kapitali themeltar investohet nga ortaku themelues në vlerë monetare. pagesa e kapitalit kryhet nga ortakët themelues pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

NENI 6 ORGANET E SHOQËRISË

Organet drejtuese të shoqërise do të janë:

- Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve – Organi më i lartë vendimarrës;
- Administratori – Organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërissë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërissë.

NENI 7 ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Shoqëria mund të administrohet nga një administrator i vetëm ose nga disa administratorë. Administratori/rët do të ushtrojë/në të gjitha kompetencat në përputhje me parashikimet e nenit 95 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, Statutit dhe/ose aktit të emërimit.

Me këtë Akt caktohet Administratori i parë i shoqërissë Znj. **Bukurije Dragjoshi**, lindur me 18/04/1967, me banim në Tiranë, me nr. personal (ID) G75418116C, me një afat 5 vjeçar, me të drejtë rizgjedhje.

Administratori i emëruar do të ketë të drejtën dhe detyrimin të ushtroj të gjitha kompetencat që parashikohen nga ligji nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, si dhe çdo akt tjeter ligjor në funksion të shoqërissë.

NENI 8 VITI FINANCIAR

Viti finanziar i Shoqërissë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përashtimi, viti i parë finanziar fillon nga data e regjistrimit të shoqërissë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbylltet me 31 Dhjetor.

NENI 9 ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqërissë duhet të diskutohen për gjetjen e zgjidhjeve me mirëkuptim. Në rast se palët nuk gjejne zgjidhje për mosmarrëveshjen e tyre sipas pikave të mësipërme atëhere ato mund ti drejtohen gjykave kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.



NENI 10
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Për sa nuk është parashikuar në këtë akt themelim, rregullimi i modaliteteve të tjera që lidhen me funksionimin e shoqërisë do të bëhet sipas dispozitave të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", si dhe çdo ligji të veçantë që është në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Ky Akt themelimi është hartuar me 3 (tre) kopje në gjuhën Shqipe.

Nënskruhet sot me datë 08 Mars 2024.

ORTAKU I VETËM THEMELUES

Blerim DRAGJOSHI



A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Blerim Dragjoshi'. Below the signature is a stylized, horizontal, handwritten mark or signature.